



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 457/4 Prot.

Tiranë, më 28.05.2018

VENDIM

Nr. 52 , datë 28.05.2018

“Mbi verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 1059/1 prot., datë 01.06.2017, të njësisë së burimeve njerëzore të ISHPSHSH, për lirimin nga shërbimi civil të nëpunësit

*******”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit dhe materialit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit paraprak të informacionit të marrë nga kërkesa e nëpunësit *****,

VËREJ SE:

Nëpërmjet kërkesës së regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 457 prot., datë 18.05.2018, kërkuesi ***** ka ngritur pretendimin se njësia e burimeve njerëzore në institucionin e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, në momentin kur ka vendosur lirimin e tij nga shërbimi civil, nëpërmjet zbatimit të institutit të dorëheqjes, për shkak të emërimit të tij në pozicionin e Prefektit të Qarkut Dibër, ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 54, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ndërsa duhej tëkonstatonte shkakun e pezullimit.

Nga verifikimi i këtij rasti, rezultoi se, punonjësi ***** , në përfundim të procedurës së rregullt të konkurrimit, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në

pozicionin Kryeinspektor i Degës Rajonale të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Qarku Dibër. Në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr. 947 prot., datë 08.06.2015, të Kryeinspektorit të ISHPSHSH (në cilësinë e eprorit direkt) është konfirmuar “Nëpunës civil”, në pozicionin e mësipërm.

Gjatë kohës që kryente këtë detyrë, rezulton se me vendimin nr. 374, datë 25.05.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për emërimin në detyrë të Prefektit të Qarkut Dibër”, ky nëpunës është emëruar në pozicionin “Prefekt i Qarkut Dibër”.

Pas vërtetimit të rrethanës së mësipërme, duke e perceptuar gabim rastin, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në ISHPSHSH, në zbatim të nenit 64, “Dorëheqja” dhe nenit 66, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me vendimin nr. 1059/1 prot., datë 01.06.2016, ka vendosur lirim nga shërbimi civil për nëpunësin në fjalë, duke sugjeruar me këtë rast dhe nënshkrimin e një kërkesë për dorëheqje (në datën 31.05.2016), nga nëpunësi *****.

Më tej, rezulton se me vendimin nr. 410, datë 03.05.2017, të Këshillit të Ministrave, shtetasi ***** është liruar nga detyra e Prefektit të Qarkut Dibër, duke mbetur në këtë mënyrë, i pazgjidhur vazhdimi i mëtejshëm i punësimit të tij në shërbimin civil.

Nga analiza në tërësi e dokumentacionit dhe rrethanave të çështjes, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, vlerëson se, në rastin e mësipërm, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në institucionin e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe Departamenti i Administratës Publike si njësi përgjegjëse, duke aplikuar institutin e dorëheqjes dhe jo atë të pezullimit nga shërbimi civil, që parashikohet për këto raste, kanë vepruar në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Pezullimi nga shërbimi civil, i cili parashikohet në Kreun IX, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, konsiston në ndërprerjen e përkohshme të marrëdhënies në shërbimin civil, në ato raste kur organet kompetente vlerësojnë se nëpunësi, për nevoja pune, duhet të kryejë detyra të një niveli më të lartë se ai ekzistues. Ky mekanizëm shërben si një garanci për mbrotjen e të drejtave të nëpunësit civil, i cili me mbarimin e periudhës së pezullimit, ka të drejtën e rikthimit në pozicionin e mëparshëm të punës ose të transferimit në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori, nëse ndërkohë, pozicioni i mëparshëm i punës është plotësuar përfundimisht.

Legjislacioni për shërbimin civil, parashikon në mënyrë të shprehur shkaqet dhe rastet e pezullimit të një nëpunësi nga shërbimi civil. Konkretisht, në referencë të nenit 54, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nëpunësi civil gëzon të drejtën e pezullimit nga shërbimi civil, në rastet kur ai emërohet në një nga funksionet e

parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “gj”, të nenit 2, të po këtij ligji, për periudhën përkatëse të kryerjes së asaj detyre.

Sipas nenit 54, pika 3, germa “a”, të ligjit të sipërcituar si dhe Kreut 1, pika 3 dhe 7, të vendimit nr. 124, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil*”, konstatimi i pezullimit është detyrë e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi civil është i emëruar, e cila nis procedurën në institucionin e saj, për verifikimin e shkakut të pezullimit. Pas konstatimit të shkakut të pezullimit, në bazë të pikës 14, të vendimit nr. 124, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil*”, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore i njofton pezullimin e nëpunësit civil, njësisë përgjegjëse (*që në rastin konkret paraqitet Departamenti i Administratës Publike*), e cila në këtë kohë merr dhe detyrimin për rikthimin e nëpunësit civil, në përfundim të periudhës së pezullimit, në vendin e mëparshëm në shërbimin civil, sipas kushteve të pikës 1, të nenit 56, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar.

Në rastin konkret, rezulton se, ekzistojnë të gjithë elementet e kërkuara nga dispozita e nenit 54, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar; pozicioni i Prefektit, në të cilin ka qenë i emëruar punonjësi *****, klasifikohet në ***kategorinë e funksionarëve të emëruar nga Këshilli i Ministrave***; në kuptim të nenit 2, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, pozicionet e mësipërme përjashtohen nga skema e shërbimit civil, kontradiktë e cila është zgjidhur nëpërmjet institutit të pezullimit, që do të thotë se nëpunësit civilë, për periudhën që kryejnë këtë detyrë, në zbatim të nenit 54, të ligjit në fjalë, duhet të pezullohen për shkak të ligjit.

Tërësia e fakteve të mësipërme, përcaktojnë se, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, me marrjen dijeni të emërimit të nëpunësit civil *****, në pozicionin e Prefektit të Qarkut Dibër, duhet të kishte vendosur konstatimin e shkakut të pezullimit sipas pikës 3, të nenit 54, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe urdhërimin për pezullimin e tij nga shërbimi civil, për periudhën e ushtrimit të detyrës së funksionarit politik.

Theksojme se, dorëheqja e paraqitur nga ky nëpunës në datën 31.05.2016, nuk përlligj vendimmarrjen për lirim nga shërbimi civil, pasi ky veprim administrativ vjen në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, gjë e cila në vështrim të nenit 109, germa “d” të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të RSH*”, e bën këtë veprim dhe aktin e lirit nga shërbimi civil dalë në zbatim të tij, një veprim dhe akt të paligjshëm të cilët, në bazë të nenit 114 pika 1, të ligjit në fjalë, duhet të anulohen

Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në çdo institucion, në kuptim të nenit 10, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, përbën mekanizmin kryesor në administrimin e shërbimit civil, e cila gjatë ushtrimit të kompetencave të saj duhet të sigurojë zbatimin e parimeve të sanksionuara për shërbimin civil, respektimin e procedurave ligjore për çdo institut të tij, si dhe garantimin e të drejtës së nëpunësit civil, për një marrëdhënie pune të qëndrueshme, kompetencë e cila rezulton të mos jetë ushtruar si duhet, në rastin e kërkuesit në fjalë.

Në rastin konkret, njësia e burimeve njerëzore dhe njësia përgjegjëse, kishin detyrën të bënin konstatimet e kushteve ligjore, t’i jepnin orientimet e duhura nëpunësit në përputhje me ligjin, me qëllim mos cënimin padrejtësisht të të drejtave ligjore tëparashikuara nga ligjvënësi. Moskryerja si duhet e rolit të garantit për zbatimin e ligjit, nëpërmjet dhënies së sugjerimeve të pasakta ligjore në këtë rast, ka bërë që nëpunësi ******, të dalë padrejtësisht jashtë skemës së shërbimit civil dhe të mos përfitojë nga parimi i vazhdimësisë së marrëdhënies në shërbimin civil, që parashikohet në nenin 5, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

Si përfundim, për të gjitha arsyet që analizuam më sipër, rezulton se akti administrativ nr. 1059/1 prot., datë 01.06.2016, i Drejtorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të ISHPSHSH, *“Për lirim nga shërbimi civil”*, për lirimin e nëpunësi ***** nga detyra, për shkak të dhënies së dorëheqjes, është një akt i cili, ka dalë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe si ti i tillë, në kuptim të nenit 109, pika “d”, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, përbën një akt administrativ të paligjshëm.

Në vijim të këtij arsyetimi, siç u tha dhe më sipër, në bazë të nenit 113 dhe 114, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, njësia e burimeve njerëzore të ISHPSHSH, duhet të anulojë aktin për lirimin nga shërbimi civil dhe më tej, në zbatim të nenit 54, pika 3, germa “a”, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, duhet të nxjerrë aktin e konstatimit të shkakut të pezullimit, duke ia komunikuar këtë akt Departamentit të Administratës Publike si dhe nëpunësit *****.

Nga ana e tij, Departamenti i Administratës Publike, në zbatim të nenit 56, pika 1, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, dhe Kreut II, të vendimit nr. 124, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”*, nëse pozicioni i tij i punës është vakant, duhet të marrë masa për rikthimin e nëpunësit ***** në pozicionin e mëparshëm të punës dhe nëse konstatohet qëky pozicion është zënë në mënyrë përfundimtare, të vendosë transferimin e tij në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori, duke e mbajtur ndërkohë në listë pritje deri në sistemimin e tij në një pozicion të rregullt në shërbimin civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkojë nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, të anulojë aktin 1059/1 prot., datë 01.06.2016, i të Drejtorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të ISHPSHSH, *“Për lirim nga shërbimi civil”*, si një akt i dalë në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.
2. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të ISHPSHSH, në zbatim të nenit 54, pika 3, germa “a”, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, të nxjerrë aktin e konstatimit të shkakut të pezullimit, duke ia komunikuar këtë akt Departamentit të Administratës Publike si dhe nëpunësit *****.
3. Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, nëse pozicioni i tij i mëparshëm i punës është vakant, duhet të marrë masa për rikthimin e nëpunësit ***** në këtë pozicion pune dhe nëse konstatohet që ky pozicion është zënë në mënyrë përfundimtare, të vendosë transferimin e tij në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori, duke e mbajtur ndërkohë në listë pritje deri në sistemimin e tij në një pozicion të rregullt në shërbimin civil.
4. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe Departamenti i Administratës Publike, të zbatojnë vendimin brenda 5 ditëve nga data e marrjes dijeni dhe pas përfundimit të këtij afati, të njoftojë me shkrim Komisionerin për zbatimin e vendimit.
5. Të njoftohen për këtë vendim paralajmërues, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Departamenti i Administratës Publike dhe kërkuesi *****.
6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, duke

përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha